



PARANDALIMI I TRAFIKIMIT TË FËMIJËVE

Material informues për mbrojtjen
e fëmijëve nga trafikimi i qenieve njerëzore
për nxënësit e shkollave të mesme

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



EUROPEAN UNION

COUNCIL OF EUROPE




CONSEIL DE L'EUROPE

Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



MINISTERTETI I SHKOLLËVE DHE SHKENCËVE - BUREAU DU DÉVELOPPEMENT DE L'ÉDUCATION
MINISTERIA E ARSIMIT DHE SHKENCËVE - BYUREAU I ZWILLIMIT I ARSIMIT
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE - BUREAU FOR DEVELOPMENT OF EDUCATION



Zyra e Programit të Këshillit të Evropës në Shkup,
Qendra e Biznesit Soravia
Filip Vtori Makedonski 3,
1000 Shkup
Tel. +38923100 333

Website: <http://horizontal-facility-eu.coe.int>
E-mail: horizontal.facility@coe.int
Facebook@[jp.horizontal.facility](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility)
Twitter@[CoE_EU_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)

Autorizohet riprodhimi i ekstrakteve (deri në 500 fjalë), me përjashtim të riprodhimit për qëllime tregtare për sa kohë që ruhet integriteti i tekstit, fragmentet nuk përdoren jashtë kontekstit, nuk jepen informacione të paplota dhe nuk e keqorientojnë lexuesin sa i përket natyrës, fushëveprimit apo përmbajtjes së tekstit. Teksti burimor duhet të njihet gjithmonë si vijon “©Këshilli i Evropës, viti i botimit”. Të gjitha kërkesat e tjera në lidhje me riprodhimin/përkthimin e të gjithë këtij dokumenti ose e pjesëve të caktuara të tij, duhet t'i drejtohen Drejtorisë së Komunikimeve, Këshilli i Evropës (F-67075 Strasburg Cedex ose publishing@coe.int).

@ Këshilli i Evropës, nëntor 2021. Të gjitha të drejtat e rezervuara. I liçencuar në Bashkimin Evropian sipas kushteve të miratuara.

Ky produkt është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.

Trafikimi i qenieve njerëzore është një problem në të gjithë botën i cilësuar si krim. Duke qenë se bëhet fjalë për skllavërim të viktimës, trafikimi i qenieve njerëzore trajtohet si formë e rëndë e shkeljes së të drejtave themelore të njeriut si e drejta për jetë, për integritet, dinjitet, liri, lirinë e zgjedhjes dhe lëvizjes, dhe të drejta të tjera. Çdo njeri mund të jetë viktimë e trafikimit të njerëzve: fëmijë, gra, burra, pavarësisht nga mosha, arsimi, origjina, kombësia, feja dhe përkatësia etnike.

Trafikimi i fëmijëve nënkupton shfrytëzimin dhe abuzimin e fëmijëve që rrezikon shëndetin dhe mirëqenien e tyre fizike dhe psikologjike, si dhe zhvillimin dhe edukimin e tyre në të ardhmen. Ajo është e organizuar nën mbikëqyrjen ose kontrollin e personave që kanë përfitime materiale ose të tjera nga ai.

Shfrytëzimi është qëllimi kryesor i trafikimit të qenieve njerëzore. Ai përfshin: të gjitha format e shfrytëzimit seksual, pornografisë, punës së detyruar, servitutit shtëpiak, skllavërisë ose praktikave të ngjashme me skllavërinë, martesës së detyruar, birësimit të paligjshëm, lypjes, heqjes së organeve.

Trafikantët e shfrytëzojnë cënueshmërinë e fëmijëve. Fëmijët mund të trafikohen në vendin e tyre (trafikim i brendshëm i qenieve njerëzore) dhe në vendet e tjera (trafikimi transnacional i qenieve njerëzore).

SI NDJEHEN FËMIJËT VIKTIMA:

- Vuajnë nga mungesa e kujdesit ose keqtrajtimit fizik dhe psikologjik,
- Trajtohen si skllavër për të përfituar nga ta,
- Ndjehen të izoluar dhe të vetmuar,
- Ju shkelen të drejtat,
- Janë me shëndet të ligë ose janë të sëmurë,
- E kanë jetën në rrezik.

MËNYRAT SE SI TËRHIQEN OSE MASHTORHEN VIKTIMAT POTENCIALE :

- Rekrutimi mund të bëhet përmes **rrjeteve joformale**, të cilat përfshijnë **individë** - rekrutues që punojnë në lagje ose jashtë saj dhe ofrojnë punë sezonale, familjarë, të njohur, miq.

- Rekrutimi mund të bëhet përmes **shpalljeve në media** ku jepen lista të vendeve tërheqëse të punës, legale ose gjysmë legale në vend ose jashtë vendit (modele në një agjenci mode, kandidatë për garë bukurie, dado, kamerier/e ose këngëtar/e, punë në anije, ndërmjetësim në martesë me një të huaj).
- Vitet e fundit, viktimat e mundshme rekrutohen më shpesh përmes **Internetit**. Në fillim bëhet fjalë për një ftesë që nuk paraqet rrezik dhe miqësore për një kafe, duke u shoqëruar, deri në çastin kur vjen deri te shpallja e dashurisë, ku mund të ofrohet edhe martesë, që përfundon me shantazhë, publikim të fotove provokuese dhe turpërim.
- Viktimat e trafikimit shpesh **rrëmbehen brutalisht dhe detyrohen të kryejnë veprime kriminale**.


KUSH ËSHTË ZAKONISHT KONTAKTI I PARË NË ZINXHIRIN E REKRUTIMIT?

Më shpesh bëhet fjalë për persona që i njeh, të cilëve iu beson: mik ose mikeshë e familjes, komshi, i dashuri / e dashura, dhe ndonjëherë edhe familjarët më të afërt. Kontakti i parë gjithashtu mund të vijë nga një rekrutues ose nga një person që propozon një takim dashurie.

ÇFARË DUHET PATUR KUJDES PËR TË SHMANGUR QË TË BEHESH VIKTIMË E TRAFIKIMIT?

Nëse ndjen sikur diçka nuk është në rregull me ty dhe ndjenjat e tua:

- Jam mërzitur!
- Kam frikë!
- Nuk më ecën mësimi!
- Jam i/e trishtuar!
- Nuk kam para!
- E kam të vështirë!
- Jam pa vullnet!
- Çfarë do bëj?



Nëse ndonjëherë mendon dhe beson në një ose disa nga sa vijon:

- Askush nuk më kupton!
- Pavarësisht sa mësoj apo sa punoj, nuk do të arrij asgjë këtu!
- Besoj se jeta është më e mirë kudo në botë përveç këtu!
- Dua të bëj diçka për të ndryshuar jetën time!
- Dua të punoj dhe të kem paratë e mia!
- Dua të mësoj një gjuhë!
- Dua të udhëtoj dhe të takoj miq të rinj!

KI KUJDES

Ekziston rrezik për t'u mashtruar, joshur, shitur, skllavëruar - për t'u bërë viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore. Para se të bësh diçka, **FLIT ME NJË TË RRIATUR NË TË CILIN KE BESIM** dhe **KONTROLLO** të gjitha informacionet që i ke.

ÇFARË MUND TË NDODHË ME TY?

Gjithçka mund të duket e ligjshme, por problemet vijnë kur:

- Një shok, një i afërm mund t'ju mashtrojë,
- Agjencia do të të lidhë me një ndërmjetës të dyshimtë, që do të t'i marrë dokumentet dhe do të të fusë në marrëdhënie skllavërie ose do të të shesë,
- Do të ballafaqohesh me të vërtetën se të kanë **MASHTRUAR**, të kanë shitur pa asnjë të drejtë, pa identitet, pa para, fizikisht, seksualisht dhe psikikisht i/e keqtrajtuar- **VIKTIMË E TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE**.

SI TË SHMANGËSH RREZIKUN E REKTRUTIMIT PËRMES TAKIMEVE TË RREJSHME TË DASHURISË?

- Shmang situata ku je tërësisht i varur nga dikush.
- Nëse dikush të thotë se ju të dy duhet të shkoni jashtë vendit së bashku dhe "të filloni një jetë të re", kontrollo të gjitha detajet para udhëtimit, informo të rriturit të cilëve iu beson dhe jepi personit një kopje të pasaportës tënde; kurrë mos ia jep askujt pasaportën, madje as të dashurit tënd.
- Nëse të duket se i dashuri yt harxhon shumë para, dhe nuk e kupton se si i ka fituar, ki kujdes.

SI TA KONTROLLOSH PUNËDHËNSIN E ARDHSHËM NË VEND OSE JASHTË?

- Kontrolllo kompaninë ose personin për të cilin do të punosh - a ekziston, për sa kohë, kush janë klientët, në sa vende funksionon, cila është adresa e tij zyrtare dhe numri i telefonit dhe a është i regjistruar në institucionin përkatës.
- Kërko informata për kompaninë për të cilën do të punosh në ambasadën e vendit tënd, në vendin ku gjendet kompania.
- Sigurohu që të nënshkruash një kontratë pune.
- Para nënshkrimit të kontratës, rishikoje atë me një avokat ose një person të besuar që njeh ligjin.
- Mos nënshkruaj kontratën e shkruar në një gjuhë të huaj që nuk e kupton.
- Bëje një kopje të kontratës (për çdo rast).
- Kontrolllo nëse ka ndonjë formulim të pasaktë në kontratë, që do linte hapësirë për shpërdorim. Shembull: "në rast mos përmbushjeje të të gjitha detyrimeve të vendosura nga punëdhënësi ...", pa specifikuar askund se çfarë do të thotë me të vërtetë "të gjitha detyrimet"?

SI TË PËRGATITESH PËR NJË UDHËTIM TË SIGURT?

- Përgatite pasaportën tënde dhe disa kopje të pasaportës, dhe të paktën një kopje lëre te një prind / shok/shoqe / një person tjetër të besuar.
- Gjithmonë mbaje pasaportën dhe dokumentet e tjera personale me vete, dhe ato mund t'ia japësh vetëm policisë kufitare nëse i kërkon, dhe askujt tjetër - as ndonjë shefi, shoku, të afërmi.
- Lëre adresën dhe numrin e telefonit të vendit ku do të qëndrosh, te prindërit / shokut/shoqes / personit i të besuar.
- Shkruaj numrat e rëndësishëm të telefonit diku në rast se e humbet telefonin.
- Para se të udhëtosh, kontakto ambasadën e vendit ku po shkon dhe pyet për dokumentet dhe lejet që kërkohen për të qëndruar, studiuar ose punuar në atë vend.
- Mos ia jep telefonin askujt dhe telefono rregullisht familjen tënde.

HISTORIA E SASHKËS DO TË ILUSTROJË ÇFARË ËSHTË TRAFIKIMI I FILMIJËVE:



Quhem Sashka, jam 17 vjeçe dhe desha të studioja gjuhën italiane.

Kam një shoqe të ngushtë që vendosi që së pari të mësonte gjuhën dhe më pas shkoi në Itali për të punuar. Ishim vazhdimisht në kontakt dhe ajo kryesisht fliste se sa e lehtë ishte ta mësosh gjuhën në Itali. Dy vite me radhë vinte shpesh në shtëpi dhe kishte rroba fantastike. Më thoshte që po punon për një agjenci modelesh që rekruton njerëz të rinj vazhdimisht, veçanërisht nga vendet ku vajzat ende kanë bukuri natyrore.



E njoftova me dy vajza të tjera që donin të studionin italishten. Duke qenë se ishim në shkollë, i kërkova që të na gjente punë gjatë pushimit të verës. Ajo na premtoi se do të na gjente punë të gjithave. Na dha një ftesë nga një punëdhënësi i një agjencie që siguronte dado dhe lehtësisht morëm vizë.






Në aeroport na prisnin tre burra dhe na thanë se janë punonjës nga agjencia, dhe se do të na dërgonin në qytetin ku gjendej agjencia. Këtu u ndamë dhe shkuam me makina të ndryshme.



U befasova shumë kur agjencia na dha biletat e avionit (siç na tha shoqja ime). Po bëhesha gati dhe prindërit e mi ishin të lumtur që nuk kisha ndonjë shpenzim shtesë përveç rrobave.



Unë mbërrita në një apartament të mirë dhe shoqëruesi im ishte shumë i pashëm, më solli ushqim dhe më tha të pushoj dhe se nesër do të flasim për punën. Më kërkoi pasaportën me shpjegimin se i duhet që të më paraqesë në polici, në mënyrë që të më jepte leje pune. Mu dukë një arsyetim i mirë dhe ia dhashë pasaportën ...





Jetoja në apartamentin ku më solli burri nga aeroporti, kishte shumë burra që vinin atje ... Mi prezantonte si bashkëpunëtorët e tij. Midis tyre kishte intelektualë që përveç shërbimeve seksuale kërkonin nga unë që t'u lexoja ose t'u rrëfeja përralla.

Një ditë një klienti ia tregova historinë time për ardhjen në Itali dhe vuajtjet e mia. Ai më ledhatoi kokën dhe nuk tha asgjë.




Një ditë më pas, erdhi përsëri dhe e pyeti shefin tim nëse mund ta shoqëroja në një vend pushimi ku do të qëndronim tre ditë.



I ofroi shumë para për shërbimin. Më tha të merrja ca rroba me vete sepse atje ishte ftohtë. Bëra valixhen gati dhe u larguam.

Më dërgoi në Konsullatë dhe më dha para për t'u rikthyer me autobus kur letrat e mia të jenë gati. Nuk mund ta besoja se çfarë kishte ndodhur...



Për fat të mirë kjo ishte e vërtetë. E putha për të shprehur mirënjohjen time ndërsa ai vetëm tundi dorën dhe më tha: "Kujdesu për veten".



KY DHE RASTE TË TJERA JAPIN KËTO MESAZHE:

- Mos i beso asnjë personi pa rezervë!
- Mos i beso shpalljeve publike pa rezervë!
- Informo veten dhe tregoi të paktën një personi të cilit i beson për vendndodhjen tënde!
- Vetë bëji gati dokumentet dhe udhëtimin tënd!
- Ki besim tek vetja, aftësitë dhe ndjenjat e tua!
- Nëse ke ndonjë dyshim se ti ose dikush afër teje është në rrezik që të bëhet viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, bisedo me një të rritur të cilit i beson, arsimtarin/arsimtare tënde ose këshillohu me organizata që merren me trafikimin e qenieve njerëzore. Ata janë aty për ty, dhe janë të gatshëm të të ndihmojnë.

Zyra e Programit të Këshillit të Evropës në Shkup,
Qendra e Biznesit Soravia
Filip Vtori Makedonski 3,
1000 Shkup
Tel. +38923100 333

Website: <http://horizontal-facility-eu.coe.int>
E-mail: horizontal.facility@coe.int
[Facebook@jp.horizontal.facility](https://www.facebook.com/jp.horizontal.facility)
[Twitter@CoE_EU_HF](https://twitter.com/CoE_EU_HF)

Financuar
nga Bashkimi Evropian
dhe Këshilli i Evropës



Zbatohet
nga Këshilli i Evropës



MINISTERTËRI I SHKENCËS DHE MËSISËS - SHIPËRI I PASËRISIA DHE ADEKVATIMIT
MINISTRE E SHKENCËS DHE MËSISËS - SHIPËRI I PASËRISIA DHE ADEKVATIMIT
MINISTRY OF EDUCATION AND SCIENCE - BUREAU FOR DEVELOPMENT OF EDUCATION

Këshilli i Evropës është organizata kryesore për të drejtat e njeriut në kontinent. Ai përfshin 47 shtete anëtare, duke përfshirë të gjitha vendet anëtare të Bashkimit Evropian. Të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës janë palë e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, një marrëveshje e krijuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e ligjit. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mbikëqyr zbatimin e Konventës në vendet anëtare.

www.coe.int

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku njohuritë, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm duke ruajtur diversitetin kulturor, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i përkushtuar të shkëmbejë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të tij.

www.europa.eu



Ky produkt është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu nuk mund të merren në asnjë rast si pasqyrim i opinionit zyrtar të secilës palë.